



**Më datë 19 Mars 2020, Autoriteti i Konkurrencës ka publikuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës (refruar në vijim si "Komisioni") Nr. 685, Datë 18.03.2020 "Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore".**

Ky vendim vjen si pasojë e çeljes së hetimit nga Komisioni, në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore, nëpërmjet vendimit Nr. 684 datë 18.03.2020. Me anë të Vendimit Nr. 685, Datë 18.03.2020, Komisioni ka vendosur:

**1. Marrjen e masës së përkohshme si vijon:**

- a.** Ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në rrjetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë (importues, depo farmaceutike dhe farmaci) të materialeve paramjekësore, të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi.
- b.** Me qëllim shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit, detyrimin e të gjitha ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të materialeve paramjekësore të jenë transparent në vendosjen e çmimit të shitjes së materialeve dezinfektant, alkool dhe maska.
- c.** Aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimit e tyre në faqet zyrtare të internetit të ndërmarrjeve apo në kanalet e tjera të komunikimit.

**2. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore (sipas Vendimit Nr. 684 datë 18.03.2020).**

**3. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (1) të këtij vendimi, ndërmarrjet që do të konstatohen në shkelje **ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës** në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003.**

**4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.**

Ky vendim ka hyrë në fuqi më datë 18 Mars 2020.

*\* Theksojmë se Autoriteti i Konkurrencës ka njoftuar se duke marrë shkas nga situata e krijuar prej virusit COVID-19, do të pranojë ankesa dhe dokumentacione nga subjekte të ligjit nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (ndërmarrje/kompani, qytetarë, konsumatorë, si dhe çdo palë e interesuar), vetëm në rrugë elektronike, deri në një njoftim të dytë.*



**On 19 March 2020, the Competition Authority published the Competition Commission's decision (hereinafter referred to as "the Commission"). No. 685, dated 18.03.2020 "On the provisional measure for establishing competition in the wholesale and retail market of paramedical materials".**

This decision comes as a result of the opening of an investigation by the Commission regarding the wholesale and retail market of paramedical materials, by Decision no. 684 dated 18.03.2020. By Decision No. 685 dated 18.03.2020, the Commission has decided:

1. Taking the following interim measures:
  - a. Prohibition of the conduct of undertakings operating in the wholesale and retail network (importer, pharmaceutical warehouse and pharmacy) of paramedical materials, which directly or indirectly impose unfair trading prices or conditions.
  - b. In order to avoid abuse in the trading chain, forcing all enterprises operating in the import and wholesale market of paramedical materials to be transparent when deciding the market price of sanitizing materials, alcohol and masks.
  - c. Applying cost-oriented pricing and publishing it on official enterprise websites or other communication channels.
2. The interim measure shall be effective for a period of time until the conclusion of the investigative procedure (According to Decision No. 684 dated 18.03.2020).
3. In case of non-enforcement of the decision on interim measures referred to in point (1) of this Decision, the undertakings found to be in breach **shall be fined up to 10% of the annual turnover for a serious breach of competition** pursuant to Article 74, point 1, letter b) of law no.9121/2003.
4. The Secretary-General is responsible for enforcing this decision and notifying the interested parties.

This Decision entered into force on 18 March 2020.

*\* We remind you that the Competition Authority has announced that taking into consideration the situation created by COVID-19, it will receive complaints and documentation from entities subject to Law No.9121/2003 "On Protection of Competition" (enterprises / companies, citizens, customers, as well as any interested parties), electronically only, until further notice.*



**Autoriteti i Konkurrencës më datë 18 Mars 2020, ka njoftuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 684, Datë 18.03.2020 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore”.**

Komisioni i Konkurrencës (në vijim referuar si “Komisioni”) ka parashtruar se nisur nga disa shqetësime të publikuara në masmedia dhe ankesave të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi rritjen e çmimit të materialeve paramjekësore, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, realizoi një monitorim në këtë treg, i cili u fokusua në tregtimin e materialeve dezinfektant duarsh, alkool dhe maska, për të cilat kërkesa konsumatore ka qenë në rritje si pasojë e situatës së krijuar nga virusi COVID-19. Nga verifikimi në terren është konstatuar se:

- Tregu ka mungesë të materialeve në nivelin e tregtisë me pakicë (rrjeti farmaceutik);
- Ka ndodhur një rritje e pajustificueshme e çmimit në të gjitha nivelet e tregtimit të këtyre materialeve (depo farmaceutike dhe rrjeti i farmacive).

Nga sa më sipër, Komisioni ka konstatuar shenja të arsyeshme të një sjellje të mundshme antikonkurrese të ndërmarrjeve që operojnë në këto nivele tregtimi, e parashikuar në nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Si rezultat i sa më sipër, Komisioni ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 31 maj 2020.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga përfundimi i periudhës hetimore.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Vendimi ka hyrë në fuqi më datë 18 Mars 2020.

*\* Theksojmë se Autoriteti i Konkurrencës ka njoftuar se duke marrë shkas nga situata e krijuar prej virusit COVID-19, do të pranojë ankesa dhe dokumentacione nga subjekte të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (ndërmarrje/kompani, qytetarë, konsumatorë, si dhe çdo palë e interesuar), vetëm në rrugë elektronike, deri në një njoftim të dytë.*



**On March 18, 2020, the Competition Authority announced the Competition Commission Decision no. 684, dated 18.03.2020 “On the opening of a preliminary investigation regarding the wholesale and retail market of paramedical materials”.**

The Competition Commission (hereinafter referred to as “the Commission”) has stated that, in the light of some concerns reported from the massmedia and the complaints submitted with the Competition Authority on the price increase of paramedical materials, the Competition Authority pursuant to Article 28 of Law no. 9121, dated 28.07.2003 “On Competition Protection”, as amended, carried out a monitoring process, which focused on the trading of hand sanitizers, alcohol and masks, for which consumer demand has been increasing as a result of situation created by COVID-19. The verification revealed that:

- The market lacks materials at the retail level (pharmaceutical network);
- An unjustified price increase has occurred at all levels of trading of these materials (pharmaceutical warehouses and pharmacy chains).

In the light of the above, the Commission has found reasonable signs of a potential anti-competitive behavior of undertakings operating at these trading levels provided for in Articles 4 and 9 of Law no.9121, dated 28.07.2003, “On Competition Protection”, as amended. As a result of the above, the Commission has decided:

1. Opening of the preliminary investigation procedure in the wholesale and retail market of paramedical materials.
2. Preliminary investigation shall cover the period from 1 January 2020 to 31 May 2020.
3. The preliminary investigation report shall be submitted to the Competition Commission no later than 2 (two) months after the end of the investigation period.
4. The Secretary-General shall be responsible for the implementation of this Decision and the notification of interested parties.

The Decision entered into force on 18 March 2020.

*\* We remind you that the Competition Authority has announced that taking into consideration the situation created by COVID-19, it will receive complaints and documentation from entities subject to Law No. 9121/2003 “On Protection of Competition” (enterprises / companies, citizens, customers, as well as any interested parties), electronically only, until further notice.*



**Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka publikuar më datë 21.03.2020 Urdhrin Nr. 193 datë 20.03.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”.**

Ky Urdhër parashikon:

**A Duke nisur nga dita e hënë, datë 23.3.2020**, subjektet e mëposhtme lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre **vetëm në fashën orare 05:00 - 13:00:**

- pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë,
- pikat e tregtisë së barnave,
- produkteve mjekësore dhe
- institucionet financiare.

**B Nga ora 05.00 e dates 24.03.2020** hyn ne fuqi lista me aktivitet e përcaktuara në lidhjen si vijon: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Tabela-e-aktivi-teteve-të-lejuara-dhe-të-ndaluara.pdf>

**Aktivitetet e lejuara mund te kryen ne fashen orare 05:00 - 13:00.**

**C** Punonjësit e institucioneve financiare, të linjave prodhuese e ushqimore, dhe të gjitha aktivitetet e lejuara, sipas tabelës ne lidhjen me siper, do të lejohen të qarkullojnë vetëm për itenerarin shtëpi—punë.

Çdo rregull i përcaktuar nga urdhrat e mëparshëm, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.



**The Ministry of Health and Social Protection has published on 21.03.2020, Order no. 193 dated 20.03.2020 "On the closure or restriction of movements in the Republic of Albania".**

The Order provides for:

**A** Starting from **Monday, 23.3.2020**, the following entities are allowed to carry out their activity only at the time period **05:00 - 13:00 hours**:

- Grocery stores, including retail and wholesale points,
- drugstores,
- medical products and
- financial institutions.

**B** On **24.03.2020 from 05.00 hrs.**, enters into force the list of activities in the below link.  
<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Tabela-e-aktiviteteve-të-lejuara-dhe-të-ndaluar.pdf>

**The time slot 05.00 to 13.00 shall be applied to the allowed activities.**

**C** Employees of financial institutions, food and beverage production businesses, and any permitted activities, according to the link above, shall be allowed to circulate only for the home-work itinerary.

Any rule set forth in the preceding orders, which is inconsistent with this order, shall be abolished.



## A

### **Informacion mbi mundesinë e pagesës së detyrimeve tatimore nëpërmjet portalit e-Albania si dhe online-banking nëpërmjet bankave të nivelit të dytë**

Për të frenuar sa më shumë përhapjen e COVID-19, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon të gjithë tatimpaguesit që detyrimet tatimore mund të paguhen elektronikisht nëpërmjet bankave të nivelit të dytë.

Pagesa *online* e detyrimeve tatimore ofrohet edhe nëpërmjet Platformës Qeveritare të Pagesave në e-Albania, pa qenë nevoja të paraqiteni pranë sporteleve.

Informacion me të detajuar mbi kushtet dhe menyren e kryerjes së pagesave *online*, nëpërmjet e-Albania e gjeni duke klikuar në linkun <https://e-albania.al/Pages/HelpPayments.aspx>

Duke ndjekur linkun mund të gjeni bankat që ofrojnë shërbimin bankar *online*:  
<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/45/1280/informacion-mbi-mundesine-e-pageses-se-detyrimeve-tatimore-nepermjet-portalit-e-albania-si-dhe-online-banking-ne-bankat-e-nivelit-te-dyte>

## B

### **Njoftim i përditësuar mbi menyren e shpërndarjes së dokumentacionit tatimor**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton të gjithë tatimpaguesit se tërheqja e dokumentacionit tatimor (blloqe faturash TVSH, Model 4, dëftesa tatimore, etj) do të vijojë të kryhet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku ata janë të regjistruar, gjatë orarit zyrtar të punës, e hënë- e premte 08:00-13:00.



## A

### **Information on the possibility of payment of tax liabilities through e-Albania portal and online-banking through second level banks**

In order to curb the spread of COVID-19 as much as possible, the General Tax Directorate informs all taxpayers that tax liabilities can be paid electronically through second level banks.

Online payment of tax liabilities is also provided through the Governmental Payments Platform in e-Albania, without having to go to the counters.

You can find more detailed information on the terms and conditions of online payments by clicking on the link <https://e-albania.al/Pages/HelpPayments.aspx>

Following the link, you can find the banks that provide the online banking service:

<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/45/1280/informacion-mbi-mundesine-e-pageses-se-detyrimeve-tatimore-nepermjet-portalit-e-albania-si-dhe-online-banking-ne-bankat-e-nivelit-te-dyte>

## B

### **Updated notification on the tax documentation distribution**

The General Tax Directorate informs all taxpayers that the retrieve of tax documentation (VAT invoice books, Model 4, tax receipts, etc.) will continue to be carried out at the Regional Tax Directorate, where they are registered, during official business hours, Monday - Friday 8:00-13:00.